




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES CIVILE , MJEDISIT , BUJQESISE
PYJEVE DHE KULLOTAVE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

RELACION TEKNIK

OBJEKTI: PERROI I ZARANIKES ELBASAN
Rehabilitimi i pellgut ujëmbledhës përroit të Zaranikës dhe Rikonstrusioni i digës
dhe shtratit të përroit të Zaranikës, Elbasan (Faza e III), Rikonstruksioni i shtratit
Zaranikë Km 0 + 440 - km 3 + 100



PERSHKRIMI I SHKURTER I GJENDJES AKTUALE

Bashkia Elbasan në vazhdim të projektit për Rikostruksjonin e shtratit të Perroit Zaranike dhe duke parë dhe demtimet dhe problematikat në segmentet e pa investuara ka hartuar projektin e zbatimit të rehabilitimit të shtratit (riveshje të bazës + skarpatat anesore + berma anesore) të Perroit Zaranikë në Qytetin e Elbasanit.

Në shtratin e Perroit Zaranike me fondet e Ministrisë së Bujqësisë është ndërhyrë në vitin 2020 për riveshjen e pusit të shuarjes dhe riveshje të segmentit të parë nga diga në një gjatësi prej 440m nga piketa zero deri progresivi Km 0+440 .

Me projektin e fazës së dytë të financuar nga Ministria e Bujqësisë gjatë periudhës 2025-2026 janë duke u kryer punimet për riveshjen e shtratit të Perroit Zaranike nga progresivi Km 0+440 e në vazhdim .

Me projektin e fazës së tretë të financuar po nga Ministria e Bujqësisë parashikohet të rivishet një gjatësi prej 918m nga segmenti ku perfundon segmenti i dytë e në vazhdim.

Aktualisht gjëndja ekzistuese veshjes me beton në segmentin ku nuk janë kryer investimet me fazën e parë dhe të dytë paraqitet problematike pasi kostatohen mjaft zgavra në mesin e bazës gjatë gjithë gjatësisë, të cilat mund të çojnë në shkatërrime masive të veshjes me beton të bazës dhe skarpatave anesore.

Gjithashtu problemetike paraqitet situata edhe e veshjes së bazës së përroit në kanalën kryesor, e cila dëmtohet më shumë sidomos nga transportit të gurëve që transporton rrjedhja gjatë kalimit të plotave. Dëmtimi i bazës prej betoni i kanalit kryesor të përroit të Zaranikës shpesh herë dhe në shumicën e rasteve ka sjellë si pasojë edhe dëmtimin apo shkatërrimin pjesor të veshjes prej betoni të skarpatave në gjatësi të konsiderueshme.

Punime rehabilituese të parashikuara në projektin : *Rikonstruksioni i digës dhe shtratit të përroit të Zaranikës, Elbasan (Faza e III)*, përfshijnë riveshje të plote të shtratit të përroit (bazës të kanalit, skarpatave anesore) me shtresë betoni të armuar , me gjatësi totale L= 918 m në segmentin (KM. 0+440 deri KM. — 3+100).

Në vazhdim të këtij raporti po paraqesim disa pamje të veshjes së shtratit të përroit Zaranike , ku jepet qartë një tablo e dëmtimeve dhe shkatërrimeve të përroit Zaranike .

Pamje te gjendjes ekzistuese te perroit Zaranike ne segmentet ku do kryhet investimi.



Trashësia e veshjes së re është parashikuar ne kete projekt eshte e njejte me dy fazat e para ku baza do te rivishet me trashesi te betonit $t = 35$ cm dhe skarpatat anesore me trashesi $t = 25-30$ cm dhe 15 cm per bemat . Betoni i veshjes do të jetë i klasit C25/30 dhe do të armohet me dy zgara metalike me hekur $\varnothing 10$ çdo 10 cm largesi . Zgara e sipërme do të ketë diametrin e shufrave $\varnothing 10$ mm, po ashtu dhe ajo e poshtme $\varnothing 10$ mm. Shtresa mbrojtëse e betonit do të jetë 5 cm sipër dhe poshtë, që do të thotë se largësia midis dy zgarave do të jetë 25 cm. Në veshjen e re do të lihen fuga gjatësore në çdo 12 m gjerësi në mënyrë të tillë që fugat e veshjes së vjetër të mbulohen nga veshja e betonit. Fugat e bazes dhe skarpates do te jene te

sfazuara me 6 m ,trashësia e fugës të jetë 3 cm e cila do te realizohet me derrase importi e stazhinuar dhe e trajtuar me prajmer- antilageshtire . Para se të hidhet betoni i veshjes së re veshja e vjetër to të hiqet dhe pastrohet me kujdes mesatarisht çdo 1,5-2 cm thellësi, aty ku do te lidhet me betonin e ri, pasi paraqet beton të shkatërruar dhe të përjaur edhe nga agjentët atmosferikë . Riparimi i sementeve te demtuar behet duke bere paraprakisht prerjen dhe pastrimin e te gjithë pjese se demtuar e te shkaterruar , pastaj behet mbushja me zhavor lumi i cili ngjishet me shtresa cdo 25cm . Mbushja e seksionit te demtuar behet deri ne seksionimin e shtratit per te krijuar neshtresen e betonit te bazes dhe skarpates . Betonimi i seksioneve te demtuara eshte me nje shtrese, trashësia e shtreses është parashikuar të jetë 35 cm per bazen , 35-25 cm per skarpatat anesoie dhe 15 cm per berrat . Betoni i veshjes do të jetë i klasit C25/30 dhe do të armohet me dy zgara metalike me hekur Ø10 çdo 12 cm largësi.

Zgara e sipërme do të ketë diametrin e shufiave Ø10 mm, po ashtu dhe ajo e poshtme Ø12 mm. Shtresa mbrojtëse e betonit do të jetë 5 cm sipër dhe poshtë, që do të thotë se largësia midis dy zgarave do të jetë 25 cm. Betonimi duhet planifikuar ne temperatura te pershtateshme 5 - 30'c . Mbas betonimit veshja duhet mbrojtur dlle lagur per 7 dite per te shmangur plasairitjet.Specifikimet teknike për materialet e ndërtimit, veçanërisht për betonin dhe përbërësit e tij, si dhe për hekurin e armimit të veshjes jepen në paragrafin e veçantë të specifikimeve teknike, bashkëngjitur këtij raporti.

Ne menyre te permbledhur punimet per realizimin e objektit: “Reabilitimin e pellgut ujembledhes te Zaranikes dhe rikostruksion i diges dhe shtratit te Perroit te Perroit Zaranikes (Faza III-te Rikostruksion i shtratit Km 0+440 deri ne Km 3+100)”, jane si vijon :

1.- Riveshje e shtratit Zaranike (bazedhe skarpatave anesore) me shtrese betoni te armuar , me gjatesi totale $L = 918$ m nga piketa ku perfundon faza e dyte e te cila do te jete dhe percaktohet mbas azhornimit dhe marrjes dorezim nga Bashkia Elbasan para lidhjes se kontrates me operatorin fitues te cilit do ti dorezohet dhe projekti i zbatimit per kete faze punimesh.

Zhvillimi i Projekt Zbatimit

Per hartimin e projektit per reabilitimin e Perroit Zaranike eshte marre stafi inxhinerik i Bashkise Elbasan

Projekti i zbatimit te punimeve do ti dorezohet Kontraktorit para lidhjes se kontrates

Piketa e fillimit te projektit do te percaktohet nga Bashkia Elbasan pas dorezimit kontrates se fazas se dyte e cila eshte ne perfundim.

Elementet hidraulit te Perroit Zaranike

Prurjet e projektuara qe trasporton Perroi Zaranike jane nga 120 m³/s deri 300 m³/s , te ndara ne dy seksione.

Elementet hidraulike te kanalit do te jene si me poshte:

- Progresivi 0+440 ml deri ne progresivin 3+100 ml

Q1 — 120 m' / sek, Q2 — 320 m' / sek, b=6,5-7 m, h= 1,8-2.2, i=1,17, m=1, n=0.02

Metodologjia e punimeve per per objektin : Reabilitimin e pellgut ujembledhes te Zaranikes dhe rikostruksion i diges dhe shtratit te Perroit te Perroit Zaranikes (Faza III – te *Rikostruksion i shtratit Km 0+440 deri ne Km 3+100*). Sipas gjendjes aktuale te shtratit te Perroit Zaranike nga veifikimit ne vend i segmenteve te pa rikostruktuar eshte hartuar projekti i rikostruksjonit te shtratit (Faza III – te). Ky projekt konsiston ne riparimin total te dy segmenteve te demtuar dhe riveshje te shtratit (bazes , skarpatave anesore dhe bermes se seksjonit te pare) , me shtrese betoni te armuar me gjatesi totale L= 918 ml nga pika fundore e rikostruksionit te fazes se (II- te).

- Volumet e Punimeve

Reabilitimin e pellgut ujembledhes te Zaranikes dhe rikostruksion i diges dhe shtratit te Perroit te Perroit Zaranikes (Faza III – te *Rikostruksion i shtratit Km 0+440 deri ne Km 3+100*). Volumet e punimeve jane nxjere nga profilat gjatesor dhe sipas seksioneve terthore te kanalit transportues te Zaranikes. Volumi i veshjes me beton te armuar eshte llogaritur per trashesi te veshjes tv= 35 per bazamentin, 25 dhe 20 per skarpates dhe 15cm per bermat me beton C/25/30.

- Konkluzione

Ne perfundim te projektit per Reabilitimin e Perroit Zaranike konkludojme si me poshte:

1. Ne projekt jane perfshire te gjithë seksionet e demtuara segmentin objekt i ketij projekti me gjatesi me gjatesi totale L= 918 ml nga pika fundore e rikostruksionit te fazes se (II- te).
2. Jane hartuar planimetria e pergjithshme e Perroit Zaranike , profilat gjatesor,profilat terthor per çdo pikete
3. Preventivi i zbatimit është vlerësuar sipas VKM. Nr.216 datë 13.04.2023 “ Per krijimin dhe funksjonimin e sistemit te integruar per informatizimin te manualit te cmimeve, per zerat e punimeve ne ndertim .

- Preventivi i Punimeve

Preventivi punimeve per objektin : Reabilitimin e pellgut ujembledhes te Zaranikes dhe rikostruksion i diges dhe shtratit te Perroit Zaranikes (Faza III – te *Rikostruksion i shtratit Km 0+440 deri ne Km 3+100*), eshte 200,989,555.04 leke me TVSH

Punoi: Ing.Arian Baku

Bsc.Blerta Boci



MIRATOI

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Ndricim Sinani